



A.nr.388/2026

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.388/2026 të datës 01.04.2026, të parashtruar nga ankuesit H. L, A. R. Sh., E. S, H. Rr, M. M, G. R, A. Z,V. S, S. A L, Sh. N dhe V. D, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson ankuesi H. L, nga Fushë Kosova, në çështjen juridike, “*Kompensim material*”, duke vepruar në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 20.05.2026, mori këtë:

## V E N D I M

**I.Aprovohet si e bazuar** ankesa A.nr.388/2026, e datës 01.04.2026, e parashtruar nga ankuesit H. L, A. R. Sh., E. S, H. Rr, M. M, G. R, A. Z,V. S, S. A L, Sh. N dhe V. D.

**II.Obligohet** Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit, duke ndërmarr të gjitha veprimet që të procedohet kërkesa për shtesën e performancës për ankuesit të Thesari i Kosovës.

**III.Obligohet** Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës, që në pajtim me kërkesën e pranuar nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, të bëjnë kompensimin e mjeteve materiale për ankuesit.

**IV.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesit H. L, A. R. Sh., E. S, H. Rr, M. M, G. R, A. Z,V. S, S. A L, Sh. N dhe V. D(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesit*) më datë 31.03.2026, përmes emailit kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 01.04.2026, nën shenjën A.nr.388/2026, kundër Përgjigjes në kërkesë me numër Reference: DPSKPK/Nr.137/2026, e datës 25.03.2026, e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, lidhur me mos kompensimin e shtesës së performancës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit të Ankesave, me datë 02.04.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa ky i fundit, me datë 14.04.2026, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me dokumentet e bashkangjitura të lëndës në çështjen përkatëse ankimore.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova:** Ankesën me numër protokolli 1623/2026, të datës 01.04.2026, të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 31.03.2026; Përgjigja në kërkesë me numër Reference: DPSKPK/Nr.137/2026, e datës 25.03.2026, e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Kërkesën për shtesë të performancës e datës 17.03.2026 nga ankuesit për Drejtorin e Përgjithshëm të SKPK-së; Formularët e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesit; Akt Emërimet e ankuesve; Kopjet e ID-së së ankuesve; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.04.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 14.04.2026; Emailin e datës 03.03.2025 nga Udhëheqësja e Departamentit për Buxhet dhe Financa për F.Z; Emailin e datës 18.02.2026 nga Udhëheqësi i Departamentit për Burime Njerëzore për S.P.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës të dërguara nga palët në këtë procedurë administrative, ka konstatuar se ankesa është e bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se, ankuesi H.L sipas Akt Emërimit me Nr. 1450/2024 të datës 01.08.2024 mban pozitën *Zyrtar i Lartë për Komunikim Publik*, ankuesja A.R-Sh, sipas Akt Emërimit me Nr. 1439/2024 të datës 01.08.2024 mban pozitën *Zyrtare Ligjore*, ankuesja E.S sipas Akt Emërimit me Nr. 1472/2024 të datës 01.08.2024 mban pozitën *Zyrtare për Financa*, ankuesi H.Rr sipas Akt Emërimit me Nr. 1471/2024 të datës 01.08.2024 mban pozitën *Zyrtar për Financa*, ankuesja M.M sipas Akt Emërimit me Nr. 1417/2024 të datës 01.08.2024 mban pozitën *Zyrtare e Lartë e Burimeve Njerëzore*, ankuesja G.R sipas Akt Emërimit me Nr. 1419/2024 të datës 01.08.2024 mban pozitën *Zyrtare e Lartë e Burimeve Njerëzore*, ankuesi A.Z sipas Akt Emërimit me Nr. 1426/2024 të datës 01.08.2024 mban pozitën *Zyrtar i Lartë i Burimeve Njerëzore*, ankuesja V.S sipas Akt Emërimit me Nr. 1433/2024 të datës 01.08.2024 mban pozitën *Zyrtare për të Hyra*, ankuesja S.A-L sipas Akt Emërimit me Nr. 1425/2024 të datës 01.08.2024 mban pozitën *Zyrtare e Lartë e Burimeve Njerëzore*, ankuesi Sh.N sipas Akt Emërimit me Nr. 1864/2024 të datës 01.08.2024 mban pozitën *Zyrtar për Komunikim Publik* dhe ankuesi V.D, sipas Akt Emërimit me Nr. 1579/2024 të datës 01.08.2024 mban pozitën *Referent i Regjistrimit*, të gjithë të punësuar në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Tutje sipas provave të lëndës, rezulton se ankuesit janë vlerësuar nga mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë të tyre për vitin 2025, sipas nivelit të vlerësimit si në vijim: ankuesi H.E me notën e përgjithshme 5, ankuesja A.R-Sh me notën e përgjithshme 4.62, ankuesja E.S me notën e përgjithshme 5, ankuesi H.Rr me notën e përgjithshme 5, ankuesja M.M me notën e përgjithshme 4.85, ankuesja G.R me notën e përgjithshme 4.85, ankuesi A.Z me notën e përgjithshme 4.85, ankuesja V.S me notën e përgjithshme 4.62, ankuesja S.A-L me notën e përgjithshme 4.56, ankuesi Sh.N me notën e përgjithshme 4.92 dhe ankuesi V.D me notën e përgjithshme 4.55.

Ankuesit më datë 17.03.2026 kanë parashtruar kërkesë për shtesën për performancë të Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 25.03.2026, përmes Përgjigjes në kërkesë me numër Reference: DPSPK/Nr.137/2025, duke refuzuar kërkesën e ankuesve, me arsyetimin se edhe përkundër planifikimit të mjeteve të nevojshme buxhetore për mbulimin e të gjitha shtesave përfshirë këtu edhe shtesat për performancë me Ligjin Nr.10/L-001 për Ndarjet Buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2026 nuk është miratuar buxheti në përputhje me kërkesat e paraqitura, e për rrjedhojë këto shtesa nuk kanë gjetur mbështetje financiare dhe për këtë arsye nuk ka mjete buxhetore.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes në kërkesë me numër Reference:DPSPK/Nr.137/2026, e datës 25.03.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, pretendojnë se realizimi i shtesës së performancës është obligim ligjor dhe e drejtë e fituar sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë dhe Rregullore Nr.10/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Stafit Administrativ të Sistemit Prokurorial.

Ndërsa në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 6 paragrafi 4, ku përcaktohet se : *“4. Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë”*, e duke marr për bazë këtë Këshilli Prokurorial i Kosovës ka nxjerr Rregulloren Nr. 10/2024 për Vlerësimin e Rezultateve të Punës të Stafit Administrativ të Sistemit Prokurorial.

Kolegji i Këshillit, lidhur me këtë çështje juridike-administrative, ndërlidhur me vendimmarrjen mori për bazë dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, konkretisht nenin 2 paragrafi 3,ku është përcaktuar:*“3.Për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për aq sa nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë”*, nenin 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12, ku përcaktohet: *“1. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim: 1.12. shtesë page apo shtesë - nënkupton komponentin e pagës që i shtohet pagës bazë dhe që synon të shpërblejë punën për kushte të vështira, sektorë apo specializime të veçanta dhe që nuk shpërblehet nga paga bazë. Shtesa e pagës mund të jetë e rregullt, kur përfitohet për çdo muaj apo e parregullt kur shpërblehet sipas rastit në bazë të këtij ligji”*. Me nenin 22 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, është përcaktuar: *“1. Shtesat që mund përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. shtesa e veçantë për të zgjedhurat/it; 1.2. shtesa për kushte tregu të punës; 1.3. shtesa e performancës; 1.4. shtesa për kushte specifike të punës; 1.5. shtesa për punën pa orar të paracaktuar; 1.6. shtesa për vëllimin e punës; 1.7. shtesa për licencë të avancuar për nëpunësen/in e arsimit para universitar; 1.8. shtesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor; 1.9. shtesa e performancës për krijuesen/in dhe performuesen/in e artit dhe kulturës; 1.10. shtesa funksionale”*, ndërsa me nenin 25 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4, është përcaktuar: *“1. Shtesa e performancës synon stimulimin e nëpunëses/it civil dhe nëpunëses/in e administratës së shërbimit publik të kategorisë profesionale në organizatat buxhetore që financohen nga buxheti i shtetit. 2. Nëpunësja/i civil dhe nëpunësja/i e/i administratës së shërbimit publik*

*e/i kategorisë profesionale përfiton shtesë vjetore për performancë bazuar në rezultatet vjetore të vlerësimit të punës. 3. Shtesa për performancë përfitohet vetëm nga nëpunësja/i civil dhe nëpunësja/i e/i administratës së shërbimit publik që është vlerësuar me “Arritje e Jashtëzakonshme” në vitin përkatës, në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për Zyrtarët Publik. 4. Shtesa për performancë përfitohet në fund të çdo viti, jepet sipas performancës individuale dhe paguhet në tre (3) mujorin e parë të vitit pasardhës”.*

Ndërlidhur me at që u potencue si më lartë Kolegji i Këshillit, mori për bazë edhe aktin e veçantë të nxjerr nga Këshilli Prokurorial i Kosovës respektivisht Rregulloren Nr.10/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Stafit Administrativ të Sistemit Prokurorial, respektivisht nenin 9 paragrafi 2, është përcaktuar: *“Objektivat dhe aftësitë vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati final i vlerësimit llogaritet sipas mesatares së ftuar dhe pasqyrohet si në vijim: 2.1. Nga 1 deri më pak se 1.5 nënkupton “e papranueshme”; 2.2. nga 1.5 deri më pak se 2.5 nënkupton “ka nevojë për përmirësim”; 2.3. Nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton “arrin pritshmërinë”; 2.4. Nga 3.5 deri më pak se 4.5 nënkupton “tejkalon pritshmëritë, 2.5. Nga 4.5 deri në 5 nënkupton “arritje e jashtëzakonshme”.*

Po ashtu Kolegji i Këshillit, mori për bazë edhe aktin e veçantë të Këshillit Prokurorial të Kosovës, që ka të bëjë me shtesat dhe kompensimet, respektivisht Rregulloren Nr.03/2023 për Shtesat dhe Kompensimet për të Punësuarit në Sistemin Prokurorial, e cila në nenin 20, ka përcaktuar: *“1. Shtesat që mund të përfitojë stafi administrativ në sistemin prokurorial janë: 1.1. Shtesa për kushte të tregut të punës; 1.2. Shtesa për performancë; 1.3. Shtesa për punën pa orar të paracaktuar dhe 1.4. Shtesa për vëllimin e punës, ndërsa sipas 23 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të kësaj rregulloreje, përcaktohet: 1. Për të përfitur nga shtesa e performancës, stafi i kategorisë profesionale dhe administrative teknike në sistemin prokurorial duhet t'i plotësojë kriteret e mëposhtme: 1.1. të jetë vlerësuar me nivelin “shkëlqyeshëm” në vitin përkatës, në pajtim me dispozitat relevante të legjislacionit në fuqi dhe 1.2. të mos ketë masë disiplinore aktive për shkelje të rënda. 2. Shtesa për performancë përfitohet një (1) herë në vit, në fund të çdo viti, e cila jepet sipas performancës individuale dhe paguhet në tre (3) mujorin e parë të vitit pasardhës. 3. Vlera e shtesës së performancës caktohet në përpjesëtim midis fondeve të planifikuara sipas paragrafit 5 të këtij neni dhe numrit të punësuarve përfitues për këtë shtesë. 4. Në secilën situatë, shtesa e performancës është paga bazë e stafit administrativ përfitues”.*

Andaj Kolegji i Këshillit, duke marrë për bazë dispozitat ligjore të potencuara si më lartë, gjithnjë duke u bazuar edhe në provat materiale të lëndës, konstaton se ankuesit mbajnë pozita të kategorisë profesionale dhe për rrjedhojë sipas formularëve të vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2025, të njëjtit janë vlerësuar nga mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë sipas nivelit të vlerësimit *“arritje e jashtëzakonshme”*, dhe sipas shkresave të lëndës nuk kanë ndonjë masë disiplinore aktive në fuqi për shkelje të rënda, në këtë rast referuar Ligjit Nr. 08/L-0196 për Pagat në Sektorin Publikë dhe Rregullores Nr. 03/2023 për Shtesat dhe Kompensimet për të Punësuarit në Sistemin Prokurorial, ankuesve i'u takon e drejta për kompensim të shtesës së performancës, pasi që është e drejtë e fituar sipas fuqisë së ligjit.

Përkitazi me konstatimet si më sipër, Kolegji i Këshillit, konstaton se organi i punësimit në këtë rast, Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, sipas dispozitivit të mbështetur në arsyetimin e këtij vendimi, janë të obliguar të ndërmarrin të gjitha veprimet që të procedohet kërkesa për shtesën e performancës për ankuesit të Thesari i Kosovës, në mënyrë që Thesari i Kosovës, të ndërmarr veprimet tjera.

Andaj, theksuar si me sipër e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë Juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda:A.nr.388/2026, datë 20/05/2026**

**Avdyl BEKTESHI**

\_\_\_\_\_  
**Procesmbajtës**

**Arben MEHMETI**

\_\_\_\_\_  
**Kryetar i Kolegjit**

**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve z.H. L;
- Organit të punësimit: Drejtorit të Përgjithshëm dhe Njesisë së Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.